



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



RAPORT MONITORIMI

“PAJTUESHMËRIA E PËRMBAJTJEVE PROGRAMORE TË OSHMA-ve ME PJESËN 3 TË
LICENCËS SË KPM-së”

DEPARTAMENTI I MONITORIMIT DHE ANALIZËS

Periudha e monitorimit janar-qershor 2018

Përmbajtja

Përkufizimet	4
Hyrje.....	6
Qëllimi.....	7
1. Gjetjet nga monitorimi - Përmbajtjet e përgjithshme programore sipas kategorive të OSHMA-ve.....	9
1.1 Kategoria: OSHMA-të me mbulim tokësor nacional	9
1.2 OSHMA-të me mbulim tokësor regjional/lokal	10
1.3 OSHMA-të me mbulim tokësor regjional/lokal – Regjioni i Pejës.....	10
1.4 OSHMA-të me mbulim tokësor regjional/lokal – Regjioni i Prizrenit	10
1.5 OSHMA-të me mbulim tokësor regjional/lokal – Regjioni i Gjilanit	11
1.6 OSHMA-të me mbulim tokësor regjional/lokal – Regjioni i Mitrovicës.....	12
1.7 OSHMA-të që transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes	12
RTK1	13
KTV	16
TV21.....	18
TV SYRI VISION.....	19
TV DUKAGJINI.....	21
TV OPINION	22
TV PRIZRENI	24
BALKAN TV	26
TV BESA	28
TV VALI.....	30
TV PULS	31
TV ILIRIA	32
TV TEMA.....	34
TV FESTINA	35
TV LIRIA	37
TV HERC	39

TV MITROVICA	40
TV MIR	42
TV MOST.....	43
KLAN KOSOVA	45
RROKUM TV	46
TRIBUNA CHANNEL.....	48
1ST CHANNEL	49
RTK2	51
TV KIM	53
Përfundim	55

Përkufizimet

KPM – Komisioni i Pavarur i Mediave.

DMA – Departamenti i Monitorimit dhe Analizave i KPM-së.

OSHMA – Ofrues i Shërbimit Medial Audiovizuel nënkupton personin fizik ose juridik që ka përgjegjësi redaktuese për përzgjedhjen e përmbajtjes audiovizuele të shërbimit medial dhe përcaktimin e mënyrës së organizimit të tij.

OSH – Operatori i Shërndarjes nënkupton personin juridik i cili shpërndanë shërbime mediale audiovizuele për përdoruesit përmes rrjetit kabllor, IPTV dhe çfarëdo forme tjetër të shpërndarjes jashtë brezit frekuencor radio-difuziv.

Programi i Shërbimit Publik – përbëhet nga lajmet, diskutimet dhe intervistat për çështjet me interes publik; programet edukative aktuale për të rriturit ose fëmijët që kanë nevojë për përkrahje ose ndryshojnë bindje për tema ose modele; argëtime për fëmijë me tema edukative; dokumentarët; programet kulturore, qëllimi kryesor i të cilave është të informojnë e jo të argëtojnë.

Programe Argëtuese – muzikë popullore/bashkëkohore, filma, lojra, sport, drama, komedi komerciale si dhe programe që lidhen me to.

Program informativ – nënkupton lajmet, debatet, intervista, ngjarje aktuale si dhe të gjitha programet tjera informative.

KKAV – komunikimet komerciale audiovizuele nënkuptojnë në mes tjerash reklamimin televiziv dhe teleshoppingun.

Reklamimi televiziv – çfarëdo shpallje publike e transmetuar me pagesë apo shpërblim të ngjashëm, për qëllime të vetpromovimit, që është i destinuar për promovimin e shitjes, blerjes apo qiradhënies së një prodhimi apo shërbimi, për ta shtyrë përpara ndonjë ide apo çështje, ose për të shkaktuar disa efekte tjera të dëshiruara nga reklamuesi apo nga vet transmetuesi.

Teleshoppingu – transemtimi i drejtpërdrejtë i ofertave për publikun me qëllim të ofrimit të mallrave apo shërbimeve, duke përfshirë patundshmërinë, të drejtat apo detyrimet, si shpërblim për pagesë.

Program origjinal – nënkupton programin e përbërë nga produksione vetanake, të bashkëprodhuara dhe të blera.

Program origjinal vetanak – nënkupton programin e prodhuar në tërësi nga vet OSHMA, apo nga ndonjë kompani tjetër për qëllimet e shërbimeve audio-vizuele, sipas kërkesës dhe me shpenzime të OSHMA-së.

Programi origjinal i blerë – programi për transmetimin e të cilit OSHMA ka siguruar të drejtat e transmetimit.

Program i ritransmetuar – programi i transmetuar nga një ofrues i shërimit medial audiovizual që merret tërësisht nga një OSHMA tjetër me qëllim të transmetimit të njëkohshëm.

Programi i shkëmbyer – program i shkëmbyer në mes të dy apo më shumë OSHMA-ve.

Hyrje

Në bazë të Ligjit Nr. 04/L-44, KPM-ja licencon transmetuesit publik e privat, përcakton dhe zbaton politikën e transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet si dhe përgjegjësitë e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbimet mediale audio dhe audiovizuale.

Subjektet e licencuara duhet të veprojnë në pajtueshmëri të plotë me Ligjin Nr. 04/L-44 për KPM-në, me Rregulloren për Ofruesit e Shërbimeve Mediale Audio dhe Audiovizuale KPM-2017/02 si dhe me të gjitha aktet nënligjore siç janë të përcaktuara nga KPM-ja.

Në rregulloren e lartpërmenduar përcaktohen kriteret, të drejtat dhe obligimet e të licencuarve, me qëllim të garantimit të mbrojtës së pluralizmit medial dhe interesit publik. Në këtë rregullore, përveç tjerash, janë të përkufizuara edhe kriteret programore që parashihen me nenin 6 të Rregullores, përfshirë pajtueshmërinë e skemës programore javore.

Si pjesë përbërëse e Licencës së KPM-së është edhe Pjesa 3 e Licencës, që ka të bëjë me formatin e programit javor të të licencuarve.

Sipas nenit 2.0 të Pjesës 3 të Licencës, përcaktohet se:

“Nga i Licencuari kërkohet që të njoftojë paraprakisht KPM-në për ndryshime të rëndësishme të cilat ai i propozon t’i bëjë në formatin e programit siç është përcaktuar në Pjesën 3 të Licencës. KPM-ja do ta njoftojë me kohë të Licencuarin nëse këto ndryshime të propozuara janë në përputhje me interesat publike në bazë të të cilave i është dhënë Licenca e parë, dhe nëse ato janë të tilla, KPM do të ndryshojë Pjesën 3 të Licencës në përputhje me kërkesat e të licencuarit”.

Ndërsa sipas nenit 2.1, përcaktohet se:

“Si ndryshim i rëndësishëm që kërkon informimin paraprak të KPM-së, përcaktohet ndryshimi i një të katërtës të ndonjë kategorie të Tipit të Programit ose të Burimit të Programit, ose eliminimi i ndonjërit nga kategoritë e Tabelës 1,2 dhe tre; dhe/ose një ndryshim material në llojin dhe përmbajtjen e programit siç është përcaktuar në Tabelat e paraqitura më poshtë. Ndryshime të tilla do të vlerësohen duke krahasuar me sasinë e tipave të programit, burimeve të programit dhe formatin, siç është përcaktuar në kërkesën origjinale të të Licencuarit”.

Pjesë përbërëse e Pjesës 3 të Licencës janë dhe tabelat të cilat të licencuarit i deklarojnë me rastin e aplikimit, e që kanë të bëjnë me Llojin e Programit dhe Burimin e Programit.

Lidhur me këtë, DMA ka bërë monitorimin e të licencuarve (TV) me transmetim tokësor nacional, regjional dhe lokal si dhe OSHMA-të që transmetojnë program me karakter gjeneralistik të cilat operojnë përmes operatorve të shpërndarjes e që kanë status të bartjes së obligueshme. Monitorimi është bërë për të vlerësuar pajtueshmërinë e të licencuarve me Pjesën 3

të Licencës si dhe për të patur një pasqyrë rreth përmbajtjeve programore që ofrohen për publikun në përgjithësi.

Qëllimi

Qëllimi i monitorimit të përmbajtjes programore javore të OSHMA-ve është vlerësimi i pajtueshmërisë së tyre në raport me Pjesën 3 të Licencës, të ofruar me rastin e licencimit të tyre.

Ky monitorim do të shërbej poashtu për të pasur një pasqyrë më të qartë për përmbajtjet programore të ofruara për publikun nga OSHMA-të, sipas llojit të programit të transmetuar, kategorive të tij si dhe programet e dedikuara shtresave dhe grupmoshave të ndryshme të shoqërisë. Nga ky raport monitorimi, do të bëhet edhe identifikimi i mungesës së kategorive dhe llojeve të caktuara të programeve në nivel nacional dhe regjional, varësisht mbulueshmërisë së OSHMA-ve që operojnë në regjione përkatëse. Kjo më qëllim që, në të ardhmen të ndërmerren veprime që kanë të bëjnë me sigurimin e ofrimit të programit të shumëllojshëm për kategorit e ndryshme të publikut, qoftë përmes licencimeve të reja apo përmes gjetjes së formave për subvencionim të kategorive të caktuara programore. Rezultatet e monitorimit, nga gjetjet e identifikuar do të shërbejnë edhe për plotësimin dhe avansimin e politikave të transmetimit të KPM-së.

Metodologjia

Me qëllim të arritjes së rezultateve të sakta të këtij projekti monitorues, Dpartamenti i Monitorimit dhe Analizës ka dizajnuar një metodologji specifike të grumbullimit dhe analizimit të të dhënave. Kjo metodologji konsiston në nevojën dhe natyrën e punës dhe rezultatet që pritet të nxirren nga ky projekt.

Duke pas parasysh që kemi të bëjmë me grumbullim dhe analizim të të dhënave statistikore në sasi të madhe, kemi zgjedhur metodën kuantitative të hulumtimit (monitorimit), duke e përshtatur atë me natyrën e këtij projekti. Fillimisht janë definuar dokumentet/materialet ekzistuese të hulumtimit (legjislacioni/rregulloret) dhe më pas është zgjedhur mostra¹ e këtij hulumtimi.

Materialet bazë të hulumtimit/monitorimit janë: Kushtet dhe Termet e Përgjithshme të Licencës, respektivisht Pjesa e 3 e Licencës (formati i programit)² dhe komplet arkivimi i programit të transmetuar nga OSHMA-të e përzgjedhura për monitorim për periudha kohore të caktuara sipas mostrës.

Janë përzgjedhur 25 OSHMA me program të karakterit gjeneralistik dhe ato që gëzojnë statusit e bartjes së obligueshme, të cilat janë marrë si referencë për krahasim me të dhënat e gjetura nga monitorimi. Për sigurimin e të dhënave të reja/aktuale, Departamenti i Monitorimit dhe Analizës

1 Mostra e monitorimit përfshinë njëzetë e pesë (25) OSHMA, për periudhën janar-qershor 2018.

2 Çdo OSHMA i Licencuar në KPM e ka të deponuar një format të programit javor që njihet si Kushtet dhe Termet e Licencës, respektivisht pjesa e tretë e tij. Ky format i programit i posedon të gjitha shënimet javore të sasisë së shërbimit medial audio vizuel për secilën kategori programore. Psh. Program Informativ, Program për Fëmijë etj..

ka zhvilluar monitorim individual një javor nga e hëna deri të dielën për 25 subjekte transmetuese. Mënyra e përzgjedhjes së periudhës monitoruese është bërë në mënyrë rastësore.

Grumbullimi i të dhënave është bërë nga zyrtarët monitorues, të cilët kanë monitoruar dhe vlerësuar të gjitha përmbajtjet programore të transmetuara gjatë një jave të plotë të transmetimit. Të dhënat e nxjerra janë vendosur në tabelat e krijuara për secilën OSHMA. Në këtë formë janë krahasuar format e dala nga monitorimi me format ekzistuese të programeve të deklaruara nga subjektet transmetuese me rastin e licencimit.

Për realizimin e këtij hulumtimi dhe arritjen e rezultateve konkrete janë përdorur mjete specifike të cilat DMA ka në dispozicion: sistemi i monitorimit Xentaurix³ dhe aplikacioni softuerik Microsoft Office Excel. I pari për të pasur qasje në materialin audiovizuel një javor të OSHMA-ve, kurse i dyti për futjen dhe analizimin e të dhënave në formatin e kohës (sekond). Analizimi i të dhënave është bërë për kategoritë programore si: Programe Informative, Programe për Fëmijë, Programe Edukative/ Arsimore, Programe Kulturore, Programe Argëtuese, Programe Sportive, Komunikime Komerciale Audio-Vizuele dhe Promo. Të dhënat kanë shërbyer edhe për të identifikimin e Burimit të Programit⁴ i cili ndahet në nënkategoritë si vijon: 1. Program origjinal (a) Program origjinal vetanak, b) Program origjinal i bashkëprodhuar, c) Program origjinal i blerë), 2. Program i ritransmetuar, 3. Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij.

Pas grumbullimit të të dhënave dhe kalkulimit të tyre në përqindje, ato janë pasqyruar në formë tabelare dhe vizuale përmes diagrameve, për secilën OSHMA përgjatë këtij raporti.

Gjithpërfshirja e subjekteve të monitorimit dhe natyra e licencimit të tyre:

- Tre (3) TV me mbulim tokësor nacional, 1 prej tyre është transmetues publik (RTK1) dhe 2 komercial/nacional (KTV dhe TV21).
- Gjashtëmbëdhjetë (16) TV me mbulim tokësor regjional/lokal, TV DUKAGJINI, TV SYRI VISION, TV OPINION, BALKAN TV, TV PRIZRENI, TV BESA, TV PULS, TV VALI, TV TEMA, TV LIRIA, TV FESTINA, TV ILIRIA, TV HERC, TV MITROVICA, TV MIR dhe TV MOST.
- Gjashtë (6) OSHMA që operojnë përmes OSH-ve me status të bartjes së obligueshme: KLAN KOSOVA, RROKUM TV, TRIBUNA CHANNEL, 1ST CHANNEL, RTK2 dhe TV KIM.

TV ZOOM dhe TV KISS, që operojnë me transmetim tokësor regjional, për shkaqe teknike, nuk ka qenë e mundur të monitorohen, prandaj, të dhënat për programit të transmetuar nga këto subjekte nuk janë pjesë e këtij raporti.

³ Xentaurix është një sistem i monitorimit i dizajnuar për nevojat e Departamentit të Monitorimit dhe Analizës, për monitorimin e përmbajtjeve programore të të licencuarve të KPM-së, në formë audio vizuele.

⁴ Burimi i Programit është pjesë përbërse e Kushteve dhe Termeve të Përgjithshme të Licencës, respektivisht Pjesës së Tretë të saj.

Fokus i monitorimit ishte i tërë programi i transmetuar gjatë një jave. Koha e transmetimit është bërë me përzgjedhje të rastësishme dhe ka përfshirë periudhën nga janari deri në qershor të vitit 2018.

Në raport janë pasqyruar tabelat me të dhënat e deklaruara dhe të dhënat e gjetura nga monitorimi.

1. Gjetjet nga monitorimi - Përmbajtjet e përgjithshme programore sipas kategorive të OSHMA-ve

1.1 Kategoria: OSHMA-të me mbulim tokësor nacional

Në Kosovë janë të licencuar tri (3) TV me mbulim tokësor nacional, një (1) prej tyre është transmetues publik (RTK1) dhe dy (2) komercial/nacional (KTV dhe TV21).

Sipas Pjesës 3 të Licencës së deklaruar nga këto OSHMA, formati javor i programit përbëhet prej: 21.37% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 2.60% programe për fëmijë, 12.8% programe edukative/kulturore, 49.87% programe argëtuese, 5.4% program sportiv, 4% KKAV, 3.93% paralajmërim programesh dhe 0.03% nuk është deklaruar në licencë (99.91% figuron në tabelën e licencës së TV 21) (lëshim teknik me rastin e licencimit).

Në bazë të monitorimit, në përgjithësi këto OSHMA gjatë periudhës monitoruese kanë transmetuar:

31.67% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 2.65% programe për fëmijë, 19.01% programe edukative/kulturore, 29.27% programe argëtuese, 3.95% program sportiv, 8.88% KKAV dhe 4.57% paralajmërim programesh.

Në programin informativ, lajmet përbëjnë rreth 13.06% të programit javor, ndërsa në totalin e përgjithshëm të programit javor për fëmijë prej 2.65%, vetëm 0.67% është program edukativ për fëmijë i transmetuar në RTK1, ndërsa pjesa tjetër prej 1.98% përbëhet nga programi muzikor për fëmijë dhe filma të vizatuar.

Pra, në përgjithësi këto subjekte brënda një jave kanë transmetuar rreth: 57.90% program të shërbimit publik, 33.22% program argëtues dhe 8.88% KKAV.

Ndërsa, në licencë kanë deklaruar: 40.73% program të shërbimit publik, 55.27% program argëtues dhe 4% KKAV.

Nga krahasimi i të dhënave të deklaruara në licencë dhe ato në bazë të monitorimit vërehet se këto subjekte kanë rritur në masë të madhe sasinë e programit të shërbimit publik në krahasim me sasinë e % së programit zbavitës/argëtues. Sa i përket komunikimeve komerciale audiovizuale, vërehet se këto subjekte kanë transmetuar sasi rreth dyfish më të madhe të KKAV në krahasim me ato të deklaruara.

Sa i përket gjuhëve që transmetojnë, RTK1 përveç gjuhës shqipe transmeton edhe në gjuhët e komuniteteve tjera, ndërsa dy OSHMA-të komerciale transmetojnë vetëm në gjuhën shqipe.

1.2 OSHMA-të me mbulim tokësor regjional/lokal

Në Kosovë, janë të licencuar shtatëmbëdhjetë (17) OSHMA me mbulim lokal/regjional (TV) sipas 5 regjioneve përkatëse. Prej tyre 11 transmetojnë në gjuhën shqipe, 5 në gjuhën serbe, 1 në gjuhën turke.

1.3 OSHMA-të me mbulim tokësor regjional/lokal – Regjioni i Pejës

Në Regjionin e Pejës janë të licencuara dy (2) televizione me mbulim tokësor lokal/regjional, TV DUKAGJINI me mbulim lokal me seli në Pejë dhe TV SYRI VISION me mbulim regjional me seli në Gjakovë.

Sipas Pjesës 3 të Licencës së deklaruar nga këto OSHMA, formati javor i programit përbëhet prej: 25.8% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 4.2% programe për fëmijë, 23.2% programe edukative, 27.65% programe argëtuese, 5.3% programe sportive dhe 13.85% KKAV.

Në bazë të monitorimit, në përgjithësi këto OSHMA gjatë periudhës monitoruese kanë transmetuar: 21.93% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 4.14% programe për fëmijë, 24.86% programe edukative, 0.36% programe kulturore, 34.85% programe argëtuese, 2.69% programe sportive, 9.34% KKAV dhe 1.85% paralajmërim programesh.

Në programin informativ, lajmet përbëjnë rreth 6.06% të programit javor të këtyre OSHMA-ve, ndërsa program për fëmijë transmetohet vetëm në TV Syri Vision, që kryesisht përfshinë muzikë për fëmijë dhe filma vizatimor.

Në përgjithësi, në totalin javor të programit, janë transmetuar rreth 53.125% program të shërbimit publik, 37.54% program argëtues dhe 9.335 KKAV.

Sa i përket gjuhëve që transmetojnë, TV SYRI VISION dhe TV DUKAGJINI transmetojnë vetëm në gjuhën shqipe.

1.4 OSHMA-të me mbulim tokësor regjional/lokal – Regjioni i Prizrenit

Në Regjionin e Prizrenit operojnë katër (4) OSHMA me mbulim tokësor regjional me seli në Prizren, TV OPINION, BALLKAN TV, TV PRIZRENI dhe TV BESA.

Sipas Pjesës 3 të Licencës këto 4 TV të Regjionit të Prizrenit kanë deklaruar se skema e përgjithshme javore përbëhet prej: 20.61% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 8.61% programe për fëmijë, 11.39% programe edukative, 42.58% programe argëtuese, 0.92% programe sportive, 9.98% KKAV, 0.94% paralajmërim programesh dhe tjera 4.97% (tek BALLKAN TV).

Në bazë të monitorimit, në përgjithësi këto OSHMA gjatë periudhës monitoruese kanë transmetuar: 5.75% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 11.97% programe për fëmijë, 21% programe edukative, 52.74% programe argëtuese, 1.11% programe sportive, 6.99% KKAV dhe 0.46% paralajmërim programesh.

Në programin informativ, lajmet përbëjnë rreth 4.95%, ndërsa i tërë programi për fëmijë është i përbërë prej programit argëtues për fëmijë, kryesisht filma vizatimor.

Në përgjithësi, në totalin javor të programit, janë transmetuar rreth 39.17% program të shërbimit publik, 53.85% program argëtues dhe 6.99 KKAV.

Sa i përket gjuhëve transmetuese, TV PRIZRENI, TV OPINION dhe TV BESA transmetojnë program në gjuhën shqipe, ndërsa TV BALLKAN në gjuhën turke.

1.5 OSHMA-të me mbulim tokësor regjional/lokal – Regjioni i Gjilanit

Në Regjionin e Gjilanit operojnë tetë (8) OSHMA: tre (3) prej tyre me mbulim tokësor regjional me seli në Gjilan: TV PULS, TV VALI dhe TV ZOOM (Shillovë), një (1) me mbulim tokësor lokal me seli në Viti: TV ILIRIA, tre (3) me seli Ferizaj: TV TEMA me mbulim tokësor regjional, TV LIRIA dhe TV FESTINA me mbulim tokësor lokal dhe TV HERC me mbulim tokësor regjional me seli në Shtërpce. Prej tyre, pesë (5) operojnë në gjuhën shqipe (TV VALI, TV ILIRIA, TV TEMA, TV LIRIA dhe TV FESTINA) dhe tre (3) në gjuhën serbe (TV PULS, TV ZOOM dhe TV HERC).

TV Zoom për shkaqe teknike, nuk ka qenë e mundur të monitorohen, prandaj të dhënat për programit e transmetuar nga kjo OSHMA nuk janë pjesë e këtij raporti.

Sipas Pjesës 3 të Licencës së deklaruar nga këto OSHMA, formati javor i programit përbëhet prej: 18.36% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 9.38% programe për fëmijë, 6.93% programe edukative, 3.49% program kulturor, 61.87% programe argëtuese, 2.64% programe sportive dhe 14.08% KKAV.

Në bazë të monitorimit, në përgjithësi këto OSHMA gjatë periudhës monitoruese kanë transmetuar: 8.64% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 3.17% programe për fëmijë, 8.62% programe edukative, 3.61% programe kulturore, 67.87% programe argëtuese, 0.88% programe sportive, 4.1% KKAV dhe 3.11% paralajmërim programesh.

Në programin informativ, lajmet përbëjnë rreth 5.5% të programit javor të këtyre OSHMA-ve.

Ndërsa, nga totali i programit për fëmijë prej 3.17%, vetëm 0.23% i përket programit edukativ, kurse pjesa tjetër përbëhet prej muzikës për fëmijë dhe filmave vizatimor.

Në përgjithësi, në totalin javor të programit, janë transmetuar rreth 27.15% program të shërbimit publik, 68.75% program argëtues dhe 4.1% KKAV.

1.6 OSHMA-të me mbulim tokësor regjional/lokal – Regjioni i Mitrovicës

Në Regjionin e Mitrovicës operojnë tri (3) OSHMA: prej tyre dy (2) me mbulim tokësor regjional, TV MITROVICA me seli në Mitrovicë dhe TV MIR me seli në Leposaviq, dhe një (1) me mbulim tokësor lokal, TV MOST me seli në Zveçan. TV MITROVICA transmeton program në gjuhën shqipe, ndërsa TV MOST dhe TV MIR transmetojnë program në gjuhën serbe.

Sipas Pjesës 3 të Licencës së deklaruar nga këto OSHMA, formati javor i programit të përgjithshëm të tyre përbëhet prej: 34.38% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 8.79% programe për fëmijë, 16.10% programe edukative, 27.2% programe argëtuese, 7.39% programe sportive dhe 6.15% KKAV.

Në bazë të monitorimit, në përgjithësi këto OSHMA gjatë periudhës monitoruese kanë transmetuar:

30.08% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 7.66% programe për fëmijë, 12.29% programe edukative, 1.92% programe kulturore, 38.39% programe argëtuese, 1.83% programe sportive, 6.02% KKAV dhe 1.44% paralajmërim programesh. Ndërsa sasia e tërësishme prej 0.37% përbënë kohën kur në një nga OSHMA-të nuk ka pasur sinjal në periudhën monitoruese.

Në programin informativ, lajmet përbëjnë rreth 5.92% të programit javor të këtyre OSHMA-ve.

Ndërsa, nga totali i programit për fëmijë prej 7.66%, 5.21% i përket programit edukativ, kurse pjesa tjetër prej 2.45% filmave vizatimor.

Në përgjithësi, në totalin javor të programit, janë transmetuar rreth 53.38% program të shërbimit publik, 40.22% program argëtues, 6.02% KKAV dhe 0.37% koha kur në një nga OSHMA-të nuk ka pasur sinjal në periudhën monitoruese.

1.7 OSHMA-të që transmetojnë përmes Operatorëve të Shpërndarjes

Në Kosovë, janë të licencuar shtatëdhjetëgjashtë (76) OSHMA që transmetojnë programe audiovizuele përmes Operatorëve të Shpërndarjes (OSH). Këto OSHMA kanë mbulim pothuajse nacionale pasi që transmetojnë përmes operatorëve të shpërndarjes të cilët mbulojnë pothuajse tërë territorin e Kosovës. Nga këto 76 OSHMA janë përzgjedhur për monitorim gjashtë (6) të tilla, të cilat ofrojnë program gjeneralistik: KLAN KOSOVA, RROKUM TV, TRIBUNA CHANNEL, 1ST CHANNEL të cilët transmetojnë në gjuhë shqipe dhe RTK2 dhe TV KIM që transmetojnë në gjuhë serbe.

Sipas Licencës së KPM-së, këto OSHMA kanë deklaruar se programi javor i tyre do të përbëhet prej: 22.89% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 3.72% programe për fëmijë, 10.17% programe edukative, 13.33% programe kulturore, 34.7% programe argëtuese, përfshirë program muzikor, filma, seriale dhe emisione zbavitëse, 5.65% programe sportive, 1.93% promo dhe 7.61% komunikime komerciale audiovizuele.

Në bazë të monitorimit, në përgjithësi këto OSHMA gjatë periudhës monitoruese kanë ofruar për publikun këtë lloj të programit: 30.48% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 2.1% programe për fëmijë, 12.99% programe edukative, 2.38% programe kulturore, 40.17% programe argëtuese, përfshirë program muzikor, filma, seriale dhe emisione zbavitëse, 2.48% programe sportive (ngjarje sportive dhe informative), 3.07% promo dhe 6.33% komunikime komerciale audiovizuele.

Lajmet përbëjnë rreth 8.45% të totalit të programit informativ, kurse nga totali i përgjithshëm i programit për fëmijë rreth 2.095%, programi edukativ përbënë 0.573% ndërsa pjesa tjetër prej 1.522% përbëhet nga muzika për fëmijë dhe filma vizatimor.

Në përgjithësi, në totalin javor të programit, janë transmetuar rreth 51.02% program të shërbimit publik, 42.65% program argëtues dhe 6.33 KKA V.

Nga krahasimi i të dhënave të deklaruara në licencë dhe ato në bazë të monitorimit vërehet se këto subjekte kanë rritur sasinë e programeve informative, ndërsa kanë zvogëluar programet për fëmijë, programet kulturore dhe programet sportive.

Rezultatet nga monitorimi – Përmbajtjet programore të OSHMA-ve

RTK1 - është televizion publik me mbulim nacional, që transmeton 24 orë program dhe në bazë të Ligjit për RTK-në përveç programit në gjuhën shqipe transmeton edhe program në gjuhët e komuniteteve që jetojnë në Kosovë.

RTK1 është monitoruar nga data 25.02.2018 deri më 03.03.2018.

Sipas Tabelës për Llojin e Programit, nga monitorimi është gjetur se RTK1 transmeton: 49.45% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 3.84% programe për fëmijë, 4.87% programe edukative, 4.11% programe kulturore, 22.04% programe argëtuese, 6.23% programe sportive, 5.54% KKA V dhe paralajmërim programesh 3.92%.

Në programin informativ, lajmet përbëjnë rreth 16.11% të programit javor, ku përveç lajmeve në gjuhën shqipe janë transmetuar edhe lajme dhe programe informative në gjuhët e komuniteteve serbe, boshnjake, turke, rome, ashkali dhe egjiptiane.

Në përgjithësi, RTK1 gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 66.19% program të shërbimit publik, 28.27% program argëtues dhe rreth 5.54% komunikime komerciale audiovizuele, përfshirë këtu reklamimin televiziv dhe teleshoping.


Ndërsa, sipas Pjesës 3 të Licencës, RTK1 ka deklaruar se skema programore javore do të përfshinë: 27% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 2%

programe për fëmijë, 6% programe edukative, 60% programe argëtuese, 4% programe sportive dhe 1% KKAV.

Nga krahasimi i të dhënave të deklaruara dhe ato të gjetura nga monitorimi shihet se ka pasur ndryshim të madh të % në kategorinë e programit të shërbimit publik dhe atij argëtues, përkatësisht rritje e % së kategorisë Lajme dhe programe politike, aktualitete, për shkak të zhvillimeve politike në vend, përfshirë këtu transmetimin e disa seancave të Kuvendit të Kosovës si dhe emisione speciale të lajmeve dhe konferencave për shtyp me rastin e vizitave të delegacioneve të BE-së dhe zvogëlim të % së kategorisë së programit argëtues, respektivisht programit muzikor.

Duke pas parasysh nenin 13 të Ligjit për RTK-në, RTK është e obliguar të mbulojë ngjarjet e veçanta të vendit dhe jashtë tij.

Në periudhën monitoruese, janë mbuluar ngjarje me rëndësi politike për vendin, përfshirë emisione speciale të lajmeve dhe konferencave për shtyp me rastin e vizitave të delegacioneve të BE-së, konferenca ndërkombëtare me rëndësi për vendin si dhe transmetimi i disa seancave të Kuvendit të Kosovës. Po ashtu, gjatë kësaj periudhe janë transmetuar edhe ngjarje të rëndësishme sportive (Lojërat Olimpike Dimërore).



Sa i përket gjuhëve transmetuese, RTK1 ka transmetuar rreth 93.56% program në gjuhën shqipe dhe rreth 6.44% program në gjuhët e komuniteteve, prej tyre për komunitetin: serb 1.72%, boshnjak 0.89%, turk 1.88%, romë 1.46%, ashkali 0.27% dhe egjiptian 0.22%.

Tabelat lidhur me gjuhët transmetuese

Programi sipas komuniteteve	(s) /javë	(%) / javë
Programet e dedikuara për komunitetin shqiptar	565842	93.56
Programet e dedikuara për komunitetet jo shqiptare	38958	6.44
Gjithsej	604800	100.00

Programet për komunitete jo shqiptare	(s) /javë	(%) / javë
Serb	10398	1.72
Boshnjak	5385	0.89
Turk	11382	1.88
Romë	8821	1.46
Ashkali	1627	0.27
Egjiptian	1345	0.22
Gjithsej	38958	6.44

Kurse, sa i përket Burimit të Programit, RTK1 ka deklaruar se përqindja e programit javor do të përbëhet prej: Program origjinal 98.81% (duke përfshirë nënkategoritë: Program origjinal vetanak 97.00%, Program origjinal i bashkëprodhuar 1.81%, Program origjinal i blerë 0.00%), Program i ritransmetuar 0.29% dhe Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij 0.90%.

Nga monitorimi vërehet se gjatë periudhës monitoruese, RTK1 ka transmetuar: Program origjinal 98.76% (përfshirë këtu nënkategoritë: Program origjinal vetanak 72.33%, Program origjinal i bashkëprodhuar 4.39%, Program origjinal i blerë 22.04%), Program i ritransmetuar 1.13% dhe Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij 0.11%.

Nga krahasimi shihet se nuk ka ndryshim prej një të katërtës sa i përket kategorive të burimit të programit. Por, nga monitorimi është vërejtur ndryshim tek nënkategoria program origjinal i blerë, ku RTK1 ka deklaruar se nuk do të transmetojë program të blerë, ndërsa gjatë periudhës monitoruese ka transmetuar rreth 22.04% program origjinal të blerë, përfshirë këtu filmat e huaj artistik, klipe muzikore, ndeshjet sportive, emisione zbavitëse etj.. Ndryshim është vërejtur edhe tek nënkategoria Program origjinal vetanak, përkatësisht zvogëlim prej 24.67%.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	98.81	98.76
	a) Program origjinal vetanak	97	72.33
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	1.81	4.39
	c) Program origjinal i blerë	0	22.04
2	Program i ritransmetuar	0.29	1.13
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	0.9	0.11
Gjithsej		100	100


KTV - është televizion komercial me mbulim tokësor nacional, që transmeton 24 orë program në ditë. KTV është monitoruar nga data 08.01.2018 deri më 14.01.2018.

Sipas Tabelës për Llojin e Programit, nga monitorimi është gjetur se KTV transmeton: 20.23% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 1.64% programe për fëmijë, 26.56% programe edukative, 3.43% programe kulturore, 27.78% programe argëtuese, 3.79% program sportive, 10.87% KKAV dhe 5.7% paralajmërim të programeve. Në programin informativ, lajmet përbëjnë rreth 6.66% të programit javor, ndërsa programi për fëmijë prej 1.64% është i përbërë nga program argëtues, përkatësisht filma vizatimor.

Në përgjithësi, KTV gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 57.56% program të shërbimit publik, 31.57% program argëtues dhe rreth 10.87% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu reklamimin televiziv dhe teleshoping.

Ndërsa, sipas Pjesës 3 të Licencës, KTV ka deklaruar se skema programore javore do të përfshinë: 14% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 4% programe për fëmijë, 7% programe edukative, 9% programe kulturore, 48% programe argëtuese, 11% programe sportive, 6% KKAV dhe 1% paralajmërim programesh.

Në bazë të monitorimit është vërejtur se ka pasur ndryshim të madh të % në kategoritë Program edukative, përkatësisht rritje të konsideruar të përqindjes krahasuar me atë të deklaruar në Pjesën e tretë të Licencës si dhe zvogëlim të sasisë së % së kategorisë së programit argëtues dhe atij sportiv. Zvogëlim të sasisë së % vërehet edhe te kategoria e Programeve për fëmijë. Nga të dhënat shihet edhe rritje e sasisë së KKAV-ve të transmetuara në krahasim me ato të deklaruar në licencë.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, KTV ka transmetuar program vetëm në gjuhën shqipe dhe nuk transmeton program për komunitetet tjera, ashtu edhe siç është deklaruar me rastin e licencimit.

Lidhur me Burimin e Programit, bazuar në të gjeturat e monitorimit, KTV ka transmetuar 64.32% program origjinal vetanak dhe 35.68% është transmetuar program i blerë, ku janë përfshirë kategoritë si serialët, filmat dhe dokumentarët. Nga këto të dhëna shihet se gjatë periudhës monitoruese, KTV ka rritur sasinë e programit të blerë në mënyrë të konsiderueshme si dhe ka eliminuar kategorinë e programit të ritransmetuar dhe nënkategorinë e programit të bashkëprodhuar.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	74	100
	a) Program origjinal vetanak	59	64.32
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	10	0
	c) Program origjinal i blerë	5	35.68
2	Program i ritransmetuar	26	0
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	0	0
Gjithsej		100	100


TV21 - është televizion komercial me mbulim tokësor nacional, që transmeton 24 orë program në ditë. TV21 është monitoruar nga data 26.02.2018 deri më 04.03.2018.

Sipas Tabelës për Llojin e Programit, nga monitorimi është gjetur se TV 21 transmeton: 25.33% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 2.47% programe për fëmijë, 6.38% programe edukative, 11.7% programe kulturore, 37.98% programe argëtuese, 1.83% programe sportive, 10.23% KKAV dhe 4.08% paralajmërim programesh. Në programin informativ, lajmet përbëjnë rreth 16.4% të programit javor, kurse programi për fëmijë përbëhet vetëm prej programeve argëtuese.

Në përgjithësi, TV 21 gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 49.96% program të shërbimit publik, 39.81% program argëtues dhe rreth 10.23% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu reklamimin televiziv dhe teleshopping.

Ndërsa, sipas Pjesës 3 të Licencës, TV21 ka deklaruar se skema programore javore do të përfshinë: 23.1% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 1.8% programe për fëmijë, 10.7% programe edukative, 5.7% programe kulturore, 41.6% programe argëtuese, 1.2% programe sportive, 5.01% KKAV dhe 10.8% paralajmërim programesh.

Në bazë të monitorimit vërehet se nuk ka ndryshime shumë të theksuara në mes të të dhënave të deklaruar dhe ato nga monitorimi. Shihet rritje e vogël tek programi për fëmijë dhe një rritje e konsideruar tek programi kulturor. Ndërsa, sa i përket komunikimeve komerciale audiovizuale, të dhënat tregojnë dyfishim të % së sasisë së transmetuar nga ato të deklaruar në licencë.



Gjatë periudhës monitoruese, ashtu siç edhe është licencuar, TV21 ka transmetuar program vetëm në gjuhën shqipe, siç është deklaruar në licencë.

Lidhur me Burimin e Programit, krahasuar me të dhënat e deklaruara vërehet se në periudhën monitoruese ka ndryshim, përkatësisht zvogëlim të madh të sasisë së programit të blerë, ndërsa nuk është transmetuar ndonjë program i shkëmbyer me subjekte tjera transmetuese, siç është deklaruar se do të ketë në licencë.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal		
	a) Program origjinal vetanak	86.6	84.11
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	0.5	
	c) Program origjinal i blerë	29	11.80
2	Program i ritransmetuar	9.7	4.09
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	0.3	
Gjithsej		126	100


TV SYRI VISION - është televizion me mbulim tokësor regional, që transmeton 24 orë program në ditë. Kjo OSHMA është monitoruar nga data 02.02.2018 deri më 08.02.2018.

Sa i përket Llojit të Programit, nga monitorimi është gjetur se kjo OSHMA transmeton: 10.89% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 8.27% programe për fëmijë, 5.59% programe edukative, 0.71% programe kulturore, 58.6% programe argëtuese, 0.7% programe sportive, 14.4% KKAV dhe paralajmërim programesh 0.9%. Në kuadër të programit informativ, lajmet përbëjnë 7.15% të tij.

Në përgjithësi, TV SYRI VISION gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 26.36% program të shërbimit publik, 59.3% program argëtues dhe rreth 14.34% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu reklamimin televiziv dhe teleshoping.

Ndërsa, sipas Licencës, skema javore e kësaj OSHMA-ja përbëhet prej: 21.6% program informativ, përfshirë lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 8.4% program për fëmijë, 21.4% programe edukative përfshirë dokumentarët, 40.3% program argëtues, përfshirë këtu filmat, serialët dhe programin muzikor, 0.6% program sportiv dhe 7.77% KKAV.

Nga krahasimi mund të shihet zvogëlim i theksuar në sasisë së % në kategoritë e programit informativ dhe atij edukativ dhe rritje të sasisë së programit zbavitës, kryesisht të programit muzikor. Ndërsa kategoritë tjera mbesin afërsisht të njëjta me ato të deklaruar në Licencë. Rritje afërsisht dyfish vërehet edhe tek sasia e % së KKAV-ve .



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Ndërsa, lidhur me Burimin e Programit, nga monitorimi vërehet ndryshim i theksuar në nënkategorin e programit origjinal të blerë, përkatësisht rritje të theksuar të % në krahasim me të dhënat e deklaruar në licencë si dhe zvogëlim të % në kategorinë e programit të shkëmbyer. Ndërsa, nga monitorimi është vërejtur se kjo OSHMA ka eliminuar kategorinë e programit të ritransmetuar.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	76	97.92
	a) Program origjinal vetanak	51.5	55.38
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	0	0
	c) Program origjinal i blerë	24.5	42.54
2	Program i ritransmetuar	9	0
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	15	2.08

Gjithsej	100	100
-----------------	------------	------------


TV DUKAGJINI – Kjo OSHMA është e licencuar si televizion me mbulim lokal tokësor me seli ne Pejë. Në bazë të monitorimit është vërejtur se programet e transmetuara janë të dedikuara më tepër me karakter nacional sesa lokal për të cilën është licencuar. Kjo OSHMA transmeton 24 orë program në ditë. Monitorimi është bërë për periudhën prej 16 deri më 22 janar 2018.

Sipas Tabelës për Llojin e Programit, nga monitorimi është gjetur se TV DUKAGJINI transmeton: 32.97% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 44.12% programe edukative, 11.1% programe argëtuese, 4.68% programe sportive, 4.33% KKAV (përfshirë këtu vetëm reklamim televiziv) dhe paralajmërim programesh 2.8%. Lajmet përbëjnë 4.97% të programit informativ.

Në përgjithësi, TV DUKAGJINI gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 79.89% program të shërbimit publik, 15.78% program argëtues dhe rreth 4.33% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu vetëm reklamim televiziv.

Ndërsa, sipas licencës, skema javore e kësaj OSHMA-ja përbëhet prej: 30% program informativ, përfshirë lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 25% programe edukative, 15% program argëtues, 10% program sportiv dhe 20% KKAV.

Nga krahasimi mund të shihet se ka rritje të theksuar të sasisë së % në kategoritë e programit edukativ dhe zvogëlim të sasisë së programit sportiv, ndërsa kategoritë tjera mbesin afërsisht të njëjta me ato të deklaruara në licencë. Sa i përket KKAV, shihet se gjatë periudhës monitoruese është transmetuar sasi tejet e vogël e reklamimit televiziv në krahasim me atë të deklaruar në licencë.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe. Ndërsa, lidhur me Burimin e Programit, nga monitorimi vërehet se nuk ka pasur ndryshim të të dhënave të deklaruar me ato të gjetura nga monitorimi.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	100	100
	a) Program origjinal vetanak	100	100
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	0	0
	c) Program origjinal i blerë	0	0
2	Program i ritransmetuar	0	0
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	0	0
Gjithsej		100	100

TV OPINION - është licencuar me datën 30 tetor 2009, si TV me mbulim regional dhe transmeton program gjeneralistik 24 orë brenda ditës. Monitorimi i kësaj OSHMA-je është bërë për periudhën 10 deri më 16 shkurt 2018.


Sipas Tabelës për Llojin e Programit, nga monitorimi është gjetur se TV OPINION transmeton: 9.35% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 11.90%

programe për fëmijë, 10.11% programe edukative, 60.46% programe argëtuese, 0.74% programe sportive, 7.13% KKAV dhe paralajmërim programesh 0.31%. Lajmet përbëjnë 9.35% të programit informativ.

Në përgjithësi, TV OPINION gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 31.67% program të shërbimit publik, 61.2% program argëtues dhe rreth 7.13% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu vetëm reklamim televiziv.

Ndërsa, në Pjesën 3 të Licencës, ky subjekt ka deklaruar se do të transmetojë: 11.31% program informativ, 3.27% program për fëmijë, 2.68% program edukativ, 61.21% program argëtues, 1.19% program sportiv, 16.67% KKAV dhe programe tjera të paspecifikuara 3.67%.

Të gjeturat nga monitorimi tregojnë se TV OPINION transmeton programe të ndryshme informative si lajmet, aktualitete, filma, emisione, dokumentar të ndryshëm dhe program zbavitës. Nga krahasimi vërehet se gjatë periudhës monitoruese ka pasur rritje të theksuar të % së programit për fëmijë dhe programit edukativ, ndërsa rënie të % së reklamimit televiziv në krahasim me të dhënat e deklaruara.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, TV OPINION transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Lidhur me Burimin e Programit, gjatë periudhës monitoruese është gjetur se TV OPINION ka transmetuar 32.83% program vetanaka nga 35% të deklaruara në Licencë, kurse ka eliminuar

nënkategorinë e programit origjinal të bashkëprodhur dhe ka rritur përqindjen të nënkategorisë së programit origjinal i blerë nga 30% në 67.17%. Nga krahasimi është vërejtur se gjatë periudhës monitoruese, ky subjekt ka eliminuar kategorinë e programit të ritransmetuar.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	75.00	100.00
	a) Program origjinal vetanëk	35.00	32.83
	b) Program origjinal i bashkëprodhur	10.00	0.00
	c) Program origjinal i blerë	30.00	67.17
2	Program i ritransmetuar	25.00	0.00
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	0.00	0.00
Gjithsej		100	100

TV PRIZRENI - është licencuar me datën 30 tetor 2009, si TV me mbulim regional dhe transmeton program gjeneralistik. Monitorimi i këtij subjekti është bërë për programin e transmetuar brenda 24 orëve, për shtatë ditë, duke filluar nga data 08 janar deri më 14 janar 2018.


Sipas Tabelës për Llojin e Programit, nga monitorimi është gjetur se TV PRIZRENI transmeton: 7.33% program informativ, përfshirë këtu lajmet dhe program për minoritete, 5.82% programe për fëmijë, 12.71% programe edukative, 63.75% programe argëtuese, 3.68% program sportiv dhe 6.71% KKAV. Lajmet kanë përbërë 5.3% të programit javor.

Në përgjithësi, TV PRIZRENI gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 25.86% program të shërbimit publik, 67.43% program argëtues dhe rreth 6.71% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu vetëm reklamim televiziv.

Në Licencë, ky subjekt ka deklaruar 89.44% në vend të 100% sa do të duhej t'i ketë tabela për Llojin e Programit (leshim teknike gjatë licencimit). Nga këto janë deklaruar: Lajme dhe programe politike, aktualitete 15.5%, programe tjera 8.92%, programe për fëmijë 10.23%, programe edukative 1.74%, program argëtues 41.99%, program sportiv 0.62% dhe KKAV 10.44%.

Nga krahasimi i të dhënave të deklaruar dhe ato të gjetura nga monitorimi shihet se ka pasur rritje të theksuar të programit argëtues, ndërsa zvogëlim të programeve informative, programit

për fëmijë dhe atij edukativ. Nga këto të dhëna shihet se janë transmetuar KKAV në sasi dukshëm më të vogël se ato të deklaruar në licencë.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, TV PRIZRENI gjatë periudhës monitoruese ka transmetuar në gjuhën shqipe me rreth 97.97% dhe në gjuhën rome, turke dhe boshnjake me rreth 2.03%.

Tabelat lidhur me gjuhët transmetuese

Programi sipas komuniteteve	(s) /javë	(%) / javë
Programet e dedikuara për komunitetin shqiptar	592512	97.97
Programet e dedikuara për komunitetet jo shqiptare	12288	2.03
Gjithsej	604800	100.00

Sa i përket burimit të programit, gjatë periudhës monitoruese është gjetur se ka pasur rritje të konsiderueshëm të programit të blerë nga 30% në 79.05%, ndërsa ka pasur zvogëlim të programit vetanak nga 35% në 14.02% dhe atë të ritransmetuar nga 25% në 1.78%.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	75	96.75
	a) Program origjinal vetanak	35	14.02
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	10	3.68
	c) Program origjinal i blerë	30	79.05
2	Program i ritransmetuar	25	1.78
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	0	1.48
Gjithsej		100	100

BALKAN TV – është televizion me mbulim tokësor regional dhe transmeton program gjeneralistik, i licencuar të transmetojë në gjuhën turke. Monitorimi i kësaj OSHMA-je është bërë për programin e transmetuar brenda 24 orëve, për shtatë ditë të javës, duke filluar nga data 08 janar deri më 14 janar 2018.

Deri me datën 12 shkurt 2017 BALLKAN TV e kishte të miratuar kërkesën nga Komisioni për heqjen e programit informativ/ Lajmeve. Më 27 janar 2017, BALLKAN TV ka lajmëruar KPM-në se ka filluar me transmetimin e edicioneve të lajmeve në orën 12:00 dhe 19:00. Por, nga monitorimi është vërejtur se ky subjekt nuk transmeton program informativ, përkatësisht lajme dhe programe politike, aktualitete siç është deklaruar në licencën e tij.


Në periudhën monitoruese ky subjekt ka transmetuar: program për fëmijë 15.81%, program edukativ 4.49%, program argëtues 76.03%, KKAV 2.77% dhe paralajmërim programesh 0.9%.

Në përgjithësi, BALLKAN TV gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 21.2% program të shërbimit publik, përfshirë programin edukativ, programin për fëmijë dhe paralajmërimet e programit, 76.03% program argëtues dhe rreth 2.77% komunikime komerciale audiovizuale.

Sipas Tabelës për Llojin e Programit të deklaruar në Pjesën 3 të Licencës, skema programore përbëhet prej: 14.09% programe informative, përfshirë lajme dhe programe politike, aktualitete, 13.14% program i mëngjesit, 5.36% programe për fëmijë, 11.78% programe edukative, përfshirë dokumentarët, 31.69% programe argëtuese, përfshirë edhe filmat, serialet dhe programin muzikor, 1.19% programe sportive dhe 3.42% KKAV.

Nga monitorimi është vërejtur se ky subjekt ka eliminuar kategorinë e programit informativ dhe programit sportiv. Ndërsa, nga krahasimi po ashtu shihet rritje tepër e madhe e programit argëtues nga 31.69% në 76.03%.

Programet e transmetuara gjatë këtyre ditëve në BALLKAN TV ishin kryesisht prodhim komercial i marrë nga jashtë dhe ritransmetime.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, BALLKAN TV transmeton në gjuhën turke.

Sa i përket Burimit të Programit, ky subjekt transmeton vetëm program të blerë rreth 97.23%, ndërsa pjesa tjetër KKAV prej 2.77% është llogaritur si program vetanak. Ndërsa, sipas Licencës, ky subjekt është deklaruar se do të transmetoj 69.84% program vetanak si dhe 2.38% program të ritransmetuar.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal		
	a) Program origjinal vetanak	69.84	2.77
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	0.00	0
	c) Program origjinal i blerë	27.78	97.23
2	Program i ritransmetuar	2.38	0

3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	0.00	0
Gjithsej		100	100


TV BESA - është licencuar si TV me mbulim regjional dhe transmeton program gjeneralistik. Monitorimi është bërë për tërë programin e transmetuar brenda 24 orëve, për shtatë ditë, duke filluar nga data 05 deri më 11 mars 2018.

Në bazë të monitorimit, lidhur me llojin e programit, gjatë periudhës monitoruese ky subjekt ka transmetuar: 6.3% program informativ, 14.33% program për fëmijë, 56.67% program edukativ, përfshirë këtu dokumentarët, 10.72% program argëtues, 11.34% KKAV dhe 0.64% paralajmërim programesh. Lajmet përbëjnë 5.15% të programit informativ. Ndërsa, prej 38.93% të dokumentarëve të transmetuar 10.65% tyre kishin të bëjnë me dokumentarë me tema nga historia e fesë islame.

Në përgjithësi, TV BESA ka transmetuar: 77.94% program të shërbimit publik, 10.72% program argëtues dhe 11.34% KKAV, përfshirë këtu reklamim televiziv.

Ndërsa, në Licencë ky subjekt ka deklaruar se skema javore do të përbëhet prej: 17.31% program informativ, përfshirë këtu lajme dhe programe politike, aktualitete, 14.68% programe për fëmijë, 28.17% programe edukative, 30.93% programe argëtuese, 0.59% programe sportive dhe 8.33% KKAV.

Nga krahasimi shihet se sasia e % së kategorisë së programit lajme dhe programe politike, aktualitete është zvogëluar dukshëm në raport me atë të deklaruar në licencë, përderisa shihet rritje në programin edukativ dhe zvogëlim të programit argëtues. Sa i përket KKAV, gjatë periudhës monitoruese, janë transmetuar vetëm reklamime televizive, ndërsa sasia e tyre shihet se ka një rritje në raport me atë të deklaruar në licencë. Ndërsa, gjatë periudhës monitoruese, është vërejtur se ky subjekt ka eliminuar programin sportiv nga 0.59% sa ka deklaruar në licencë.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, TV BESA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Sa i përket Burimit të Programit, të dhënat tregojnë se ky subjekt ka zvogëluar sasinë e programit vetanak nga 60.68% në 23.82%, ndërsa ka rritur sasinë e programit të blerë nga 26.58% në 74.64%. Po ashtu, nga krahasimi shihet se gjatë periudhës monitoruese, ky subjekt nuk ka ritransmetuar ndonjë program duke eliminuar këtë nënkategori të cilën në bazë të licencës ka deklaruar 4%.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal		
	a) Program origjinal vetanak	60.68	23.82
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	5.32	0.64
	c) Program origjinal i blerë	26.58	74.64
2	Program i ritransmetuar	4	0
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	3.42	0.90
Gjithsej		100	100


TV VALI – është e licencuar si OSHMA me transmetim tokësor regjional me seli në Gjiilan, transmeton program 24 orë. Monitorimi i këtij subjekti është bërë për periudhën 5 deri më 11 mars 2018.

Të gjeturat nga monitorimi tregojnë se TV VALI ka transmetuar: 6.59% program informativ, përkatësisht edicione të lajmeve, 0.8% programe për fëmijë, 88.74% program argëtues, 3.77% KKAV dhe 0.1% paralajmërim programesh.

Nga totali i programit të transmetuar brenda një jave (7/24h), TV VALI ka ofruar: 7.49% program të shërbimit publik, 88.74% program argëtues dhe 3.77 KKAV.

Ndërsa, sipas të dhënave të deklaruara në Licencë, skema javore e kësaj OSHMA-je përbëhet prej: 10.6% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 15% programe për fëmijë, 2.91% programe edukative, 51% program argëtues dhe 20% KKAV. Në total këto përbëjnë 99.51%, siç janë të deklaruar në licencë.

Sipas të gjeturave nga monitorimi shihet zvogëlim i kategorisë së programit informativ si dhe zvogëlim i madh i programit për fëmijë, si dhe eliminim të programit edukativ. Ndërsa, programi argëtues, është rritur nga 51% të deklaruar në licencë në 88.74 sipas të gjeturave nga monitorimi, përfshirë këtu programin muzikor i cili përbënë rreth 63.23% të programit javor. Sipas krahasim vërehet sasi dukshëm më e vogël e transmetimit të KKAV në raport me të dhënat e deklaruara në licencë.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Lidhur me Burimin e Programit, nga krahasimi i të dhënave shihet rritje e dukshme e programit të blerë dhe zvogëlim i programit origjinal vetanak si dhe zvogëlim i dukshëm i programit të ritransmetuar dhe atij të shkëmbyer.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal		
	a) Program origjinal vetanak	26	18.99
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	4	0.65
	c) Program origjinal i blerë	22	56.46
2	Program i ritransmetuar	16	1.96
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	32	21.95
Gjithsej		100	100


TV PULS - i licencuar si OSHMA me mbulim tokësor regional me seli në Gjiilan, transmeton program 24 orë në ditë. Monitorimi i këtij subjekti është bërë për periudhën 12-16 dhe 24 -25 shkurt 2018.

Sipas Tabelës për Llojin e Programit, nga monitorimi është gjetur se TV PULS transmeton: 28.77% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 4.18% programe për fëmijë, 17.58% programe edukative, 46.43% programe argëtuese, 0.42% programe sportive, 2.40% KKAV dhe paralajmërim programesh 0.22%. Lajmet përbëjnë 11.72% të programit informativ.

Në përgjithësi, TV PULS gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 50.75% program të shërbimit publik, 46.85% program argëtues dhe rreth 2.4% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu reklamim televiziv.

Ndërsa, në Pjesën 3 të Licencës ka deklaruar se programi javor përbëhet prej: 30% lajme dhe programe politike, aktualitete, 5% programe për fëmijë, 45% programe argëtuese, 5% programe sportive dhe 5% KKAV.

Nga krahasimi i të dhënave të deklaruara dhe ato të gjetura nga monitorimi shihet se TV Puls ka bërë rritje të % së kategorisë së programit edukativ, përderisa ka pasur zvogëlim të programit sportiv dhe reklamimit televiziv.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm dedikuar komunitetit serb.

Ndërsa, sa i përket Burimit të Programit, nga krahasimi vërehet se ka pasur rritje të programit të blerë dhe zvogëlim të programit të shkëmbyer, përderisa nuk ka pasur transmetim të programit të nënkategorisë program i bashkëprodhuar.


Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal		
	a) Program origjinal vetanak	20	21.93
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	5	
	c) Program origjinal i blerë	55	68.47
2	Program i ritransmetuar	5	6.02
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	15	3.59
Gjithsej		100	100

TV ILIRIA – është e licencuar si OSHMA me mbulim lokal me seli në Viti. Monitorimi i këtij subjekti është bërë për periudhën 15 deri më 21.01.2018.

Sipas Tabelës për Llojin e Programit, nga monitorimi është gjetur se TV ILIRIA transmeton: 1.43% program informativ, përfshirë këtu vetëm mbulimin e mbledhjes së kuvendit komunal, 1.4% programe për fëmijë, 73.42% programe argëtuese, përfshirë këtu vetëm muzikë, 6.98% KKAV dhe 16.77% promo/paralajmërim programesh.

Në përgjithësi, TV ILIRIA gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 2.83% program të shërbimit publik, 73.42% program argëtues (duke transmetuar vetëm muzikë) dhe rreth 6.89% reklamim televiziv, kurse pjesa tjetër prej 16.77% përbëhet nga promo/paralajmërim programesh.

Në bazë të monitorimit është vërejtur se ka pasur zvogëlim të madh prej % të sasisë së programit informativ, ku gjatë periudhës monitoruese nuk janë transmetuar asnjë edicion i lajmeve apo program tjetër informativ përveç seancës së kuvendit komunal. Po ashtu, vërehet zvogëlim i sasisë së programit për fëmijë dhe % së KKAV në krahasim me ato të deklaruara në licencë. Nga monitorimi shihet se ky subjekt ka eliminuar nga skema edhe programin edukativ dhe kulturor si dhe atë sportiv, përderisa ka pasur rritje të madhe të programit argëtues, përkatësisht atij muzikor, duke përfshirë 73.42% të skemës javore.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, TV ILIRIA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Lidhur me Burimin e Programit, nga monitorimi shihet ka ndryshime të theksuara të kategorive dhe se shumica e programit është program i blerë, rreth 81.8%. Po ashtu, nga krahasimi vërehet se ky subjekt ka eliminuar kategoritë e programit të ritransmetuar dhe atij të shkëmbyer.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	52.71	100
	a) Program origjinal vetanak		16.77
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar		1.43
	c) Program origjinal i blerë		81.80
2	Program i ritransmetuar	20	
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	27.29	
Gjithsej		100	100


TV TEMA – është e licencuar si OSHMA me mbulim tokësor regjional me seli në Ferizaj. Kjo OSHMA është monitoruar prej datës 15 deri më 21 janar 2018.

Sa i përket llojit të programit të transmetuar, në bazë të monitorimit është gjetur se kjo OSHMA ka transmetuar: 4.77% program informativ, përfshirë lajmet dhe debate/intervista, 25.02% programe edukative, 64.55% program argëtues (ku filmat artistik përbëjnë 50.03% të kësaj kategorie) dhe 5.66% KKAV, përkatësisht reklamim televiziv. Lajmet përbëjnë 3.36% të programit informativ.

Në përgjithësi, ky subjekt ka transmetuar: 29.79% program të shërbimit publik, 64.55% program argëtues dhe 5.66% KKAV.

Ndërsa, në Pjesën 3 të Licencës ky subjekt ka deklaruar se skema javor do të përbëhet prej: 11.37% program informativ përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 2.62% program për fëmijë, 5.34% programe edukative, 0.92% programe kulturore, 61.91% programe argëtuese, përfshirë programin muzikor, 3.96% programe sportive dhe 11.88% KKAV (ku totali i përgjithshëm del të jetë 98% siç është deklaruar).

Të dhënat nga monitorimi tregojnë që ka pasur zvogëlim të sasisë së programit informativ % dhe KKAV-ve dhe rritje % të programit edukativ, përderisa ky subjekt ka eliminuar nga skema programin për fëmijë, programin kulturor dhe atë sportiv.



Kjo OSHMA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe, edhe pse në Licencë ka deklaruar se do të ketë program dedikuar dialogut ndëretnik/pakicave në sasi prej 0.85%.

Sa i përket Burimit të Programit, nga të dhënat e monitorimit shihet se ka pasur zvogëlim të dukshëm të programit vetanak dhe rritje të % së programit të bashkëprodhuar dhe atij të blerë. Ndërsa në periudhën monitoruese nuk ka pasur ritransmetim të ndonjë programi.


Burimi i programit TV TEMA		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	97.20	98.98
	a) Program origjinal vetanak	36.20	10.43
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	6.05	13.23
	c) Program origjinal i blerë	53.95	75.32
2	Program i ritransmetuar	2.80	0
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	1.0	1.02
Gjithsej		100	100

TV FESTINA – është e licencuar si OSHMA me transmetim tokësor lokal me seli në Ferizaj, që transmeton 24 orë program në ditë. Monitorimi i këtij subjekti është bërë për periudhën 5 deri më 11 shkurt 2018.

Sa i përket llojit të programit, TV FESTINA në periudhën monitoruese ka transmetuar vetëm program argëtues, përkatësisht program muzikor në sasi prej 99.27% dhe KKAV 0.73%. Nga këto të dhëna shihet se ky subjekt transmeton vetëm program argëtues.

Ndërsa, në Licencë është deklaruar se skema programore javore do të përbëhet prej: 10% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 10% programe për fëmijë, 10% programe kulturore, 60% program argëtues dhe 10% KKAV.

Nga krahasimi shihet se kjo OSHMA ka larguar nga kategorinë e programit informativ, programit për fëmijë dhe programin kulturor dhe transmeton vetëm program muzikor.



Sa i përket burimit të programit, nga krahasimi shihet se ky subjekt nuk ka ritransmetuar ndonjë program gjatë periudhës monitoruese ashtu siç ka deklaruar në Licencë. Nga të dhënat e monitorimit shihet se pjesa më e madhe e programit është program i blerë.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	80	100
	a) Program origjinal vetanak		23.99
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar		
	c) Program origjinal i blerë		76.01
2	Program i ritransmetuar	20	
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij		

Gjithsej	100	100
-----------------	------------	------------


TV LIRIA - është televizion komercial me mbulim tokësor regjional, që transmeton 24 orë program në ditë. Kjo OSHMA është monitoruar nga data 11.06.2018 deri më 17.06.2018.

Sa i përket llojit të programit, nga monitorimi është gjetur se kjo OSHMA transmeton: 7.56% program informativ, përfshirë këtu vetëm lajme, 6.17% programe për fëmijë, 3.57% programe edukative, 71.22% programe argëtuese, kryesisht program muzikor, 8.42% KKAV dhe paralajmërim programesh 3.06%. Në kuadër të programit informativ, lajmet përbëjnë 7.56% të saj. Ndërsa prej 6.17% të programit për fëmijë vetëm 0.29% është program edukativ kurse pjesa tjetër program argëtues për fëmijë.

Në përgjithësi, ky subjekt gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 20.36% program të shërbimit publik, 71.22% program argëtues dhe rreth 8.42% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu reklamimin televiziv.

Ndërsa, sipas Licencës, skema javore e kësaj OSHMA-ja përbëhet prej: 16.11% program informativ, përfshirë lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 5.7% program për fëmijë, 5.26% programe edukative, 59.09% program argëtues, përfshirë këtu edhe programin muzikor, 1.75% program sportiv dhe 12.2% KKAV.

Nga krahasimi mund të shihet zvogëlim të sasisë së programit informativ dhe atij arsimor, ndërsa kemi rritje të konsiderueshme të programit argëtues, përkatësisht atij muzikor nga 46.6% në 69.47%. Ndërsa, vërehet se në periudhën monitoruese nuk ka transmetuar ndonjë emision sportiv, përkundër faktit se në licencë ka deklaruar se do të ketë 1.75% të kësaj kategorie në programin javor, por ka pasur informacione rreth sportit në kuadër të lajmeve. Po ashtu, vërehet se edhe sasia e reklamimit televiziv është zvogëluar në krahasim me të dhënat e deklaruara.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Ndërsa, lidhur me burimin e programit, nga monitorimi vërehet ndryshim i theksuar në nënkategorinë e programit e programit vetanak dhe atij të bashkëprodhuar ndërsa shihet se pjesa kryesore i përket programit të blerë në sasi prej 71.23%. Ndërsa, gjatë periudhës monitoruese nuk ka pasur ndonjë program të shkëmbyer edhe pse në Licencë ka deklaruar se kjo kategori do të përbëjë 18% të programit javor.

Burimi i Programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program Original		
	a. Program original vetanak	32	13.98
	b. program original i bashkë prodhuar	50	14.79
	c. Program original i blerë		71.23
2	Program i ritransmetuar	18	
3	Program i shkëmbyer me subjekte tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij		
Gjithsej		100	100


TV HERC – është e licencuar si OSHMA me mbulim tokoësor regional, me seli në Shtërpce, që transmeton 24 orë program në ditë. Monitorimi i këtij subjekti është bërë në periudhën prej 29 janar deri më 4 shkurt 2018.

Nga totali i programit të transmetuar brenda javës, TV HERC ka ofruar: 11.38% program informativ, ku përfshihen lajmet dhe programe politike/aktualitete, 9.64% program për fëmijë, 14.16 % programe edukative, 25.28% programe kulturore, 31.47% program argëtues, kryesisht filma, 5.71% program sportiv, 0.73% KKAV dhe 1.63% paralajmërim programesh. Lajmet përbëjnë 9.26% të programit informativ. Nga totali i programit për fëmijë prej 9.64%, vetëm 1.32% i kushtohet programit edukativ kurse pjesa tjetër prej 8.32% është program argëtues.

Në përgjithësi, ky subjekt ka ofruar: 62.09% program të shërbimit publik, 37.18% program argëtues dhe 0.73% reklamim televiziv.

Sipas Pjesës 3 të Licencës, kjo OSHMA ka deklaruar se programi javor përbëhet prej: 10% program informativ, përfshirë lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 15% program për fëmijë, 15% programe edukative, 4% program kulturor, 50% program argëtues, përfshirë këtu filmat dhe programin muzikor, 1% program sportiv dhe 5% KKAV.

Nga krahasimi vërehet se ka pasur zvogëlim të % të programit për fëmijë dhe programit argëtues, kryesisht programit muzikor, ndërsa ka pasur rritje të programit kulturor dhe atij sportiv. Sa i përket KKAV-ve, është gjetur se gjatë periudhës monitoruese sasia e transmetimit të tyre ka qenë dukshëm më e vogël se sa ajo e deklaruar në licencë.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program në gjuhën serbe.

Lidhur me burimin e programit, në bazë të monitorimit shihet se ka pasur ndryshim të sasisë së programit vetanak, ulje të përqindjes nga 20% në 11.81%, si dhe rritje të sasisë së programit të shkëmbyer nga 10% në 22.28%. Kurse, gjatë periudhës monitoruese TV HERC nuk ka ritransmetuar ndonjë program, përderisa në Licencë është deklaruar se kjo do të ketë 10% të programit javor.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal		
	a) Program origjinal vetanak	20	11.81
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	10	9.64
	c) Program origjinal i blerë	50	51.35
2	Program i ritransmetuar	10	0
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	10	22.28
Gjithsej		100	100


TV MITROVICA – është licencuar si OSHMA me mbulim tokësor regional me seli në Mitrovicë. Monitorimi i kësaj OSHMA-je është bërë për periudhën 08 deri më 14 janar 2018. Më rastin e aplikimit, ky subjekt ka deklaruar se transmeton 10 orë program në ditë, ndërsa nga monitorimi është vërejtur se transmeton 24 orë program në ditë.

Sa i përket llojit të programit, nga monitorimi është gjetur se kjo OSHMA transmeton: 28.08% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 10.35% programe për fëmijë, 14.68% programe edukative, 4.38% programe kulturore, 35.84% programe argëtuese, 0.49% programe sportive, 5.13% KKAV dhe paralajmërim programesh 1.05%. Në kuadër të programit informativ, lajmet përbëjnë 2.20% të saj, përfshirë këtu lajmet e Zërit të Amerikës (2.06%). Kurse i tërë programi për fëmijë përbëhet nga programi edukativ.

Në përgjithësi, ky subjekt ka transmetuar: 58.34% program të shërbimit publik, 36.33% program argëtues dhe 5.13% KKAV.

Sipas Pjesës 3 të Licencës, ky subjekt ka deklaruar se skema javore përmban: 25% program informativ, përfshirë lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 10% program për fëmijë, 25% programe edukative, 20% program argëtues, 10% program sportiv dhe 10% KKAV.

Nga krahasimi i të dhënave shihet ky subjekt ka zbritur sasinë e programit edukativ, sportiv dhe KKAV, përderisa ka pasur rritje të programit argëtues dhe atij kulturor.



Sa i përket gjuhës transmetuese, TV MITROVICA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Ndërsa, lidhur me burimin e programit, nga monitorimi vërehet ndryshim i theksuar në nënkategorinë e programit e programit vetanak nga 90% të deklaruar në 57.7% gjatë periudhës monitoruese, ndërsa nuk ka pasur program të bashkëprodhuar apo të shkëmbyer për dallim që në licencë janë deklaruar se do të kenë. Nga monitorimi shihet se % e konsiderueshme përbënë edhe programi i blerë prej 34.97% dhe ai i ritransmetuar prej 7.19%, e që nuk në licencë janë deklaruar se nuk do të kenë këto kategori programesh.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	95	92.67
	a) Program origjinal vetanak	90	57.7
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	5	
	c) Program origjinal i blerë		34.97
2	Program i ritransmetuar		7.19
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	5	
4	Nuk ka pasur sinjal		0.14
Gjithsej		100	100

TV MIR – është televizion me mbulim tokësor regjional me seli në Leposaviq. Monitorimi për këtë subjekt është bërë për periudhën 27 prill deri më 3 maj 2018.


Sipas monitorimit, sa i përket llojit të programit, në periudhën monitoruese skema javore është përbërë prej: 15.66% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 8.95% programe për fëmijë, 11.84% programe edukative, 0.58% programe kulturore, 49.09% programe argëtuese, 10.82% KKAV dhe paralajmërim programesh 1.95%. ndërsa, nuk ka pasur sinjal rreth 1.11%.

Në kuadër të programit informativ, lajmet përbëjnë 3.69% të saj, kurse sa i përket programit për fëmijë nga 8.95% e totalit javor, 1.62% i përket programit edukativ dhe 7.33% program argëtues.

Në përgjithësi, programi javor përbëhet prej: 38.98% program i shërbimit publik, 49.09% program argëtues, përfshirë këtu filma dhe program muzikor kryesisht dhe 10.82% KKAV. Gjatë kësaj periudhe, nuk ka pasur sinjal në përqindje prej 1.11%.

Ndërsa, në Pjesën 3 të Licencës, ky subjekt ka deklaruar 115% program, prej tyre: 35% program informativ, përfshirë lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 15% program për fëmijë, 20% programe edukative, 30% program argëtues, përfshirë këtu filmat, serialet dhe programin muzikor, 10% program sportiv dhe 5% KKAV.

Nga krahasimi i të dhënave shihet ky subjekt ka ulur sasinë e programit të shërbimit publik, përkatësisht programit informativ, programit për fëmijë dhe programit edukativ, përderisa ka pasur rritje të sasisë së programit argëtues dhe dyfishim të KKAV-ve. Po ashtu, nga monitorimi është vërejtur se është eliminuar programi sportiv nga skema javore.



Lidhur me gjuhën transmetuese, kjo OSHMA transmeton vetëm në gjuhën serbe, përderisa në skemën e deklaruar në Pjesën 3 të Licencës është deklaruar se do të kenë programe në gjuhën rome në sasi prej 15%.

Sa i përket burimit të programit, nga krahasimi i të dhënave të deklaruara dhe ato të gjetura nga monitorimi shihet se ka pasur rritje të konsiderueshme të programit të blerë prej 20% në 67.4%, përderisa % e kategorive tjera janë zvogëluar. Ndërsa, programi i shkëmbyer është eliminuar nga skema programore.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	85	98.81
	a) Program origjinal vetanak	30	26.46
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	35	4.95
	c) Program origjinal i blerë	20	67.4
2	Program i ritransmetuar	5	1.19
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	10	0
Gjithsej		100	100

TV MOST – është televizion me mbulim tokësor lokal me seli në Zveçan. Monitorimi për këtë subjekt është bërë për periudhën 28 maj deri më 3 qershor 2018.


Sipas monitorimit, sa i përket llojit të programit, në periudhën monitoruese skema javore është përbërë prej: 46.51% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 3.67% programe për fëmijë, 10.34% programe edukative, 0.79% programe kulturore, 30.24% programe argëtuese, 5.01% programe sportive, 2.11% KKAV dhe paralajmërim programesh 1.33%. Në kuadër të programit informativ, lajmet përbëjnë 11.88% të saj.

Në përgjithësi, programi javor sipas monitorimit përbëhet prej: 62.64% program i shërbimit publik, 35.25% program argëtues dhe 2.11% KKAV.

Ndërsa, në Pjesën 3 të Licencës, ky subjekt ka deklaruar se skema programore do të përbëhet prej: 24.47% program informativ, përfshirë lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 11.8% program për fëmijë, 8.35% programe edukative, 39.6% program argëtues, përfshirë këtu filmat, serialët dhe programin muzikor, 3.04% program sportiv dhe 12.74% KKAV.

Nga krahasimi i të dhënave është vërejtur rritje e dukshme e sasisë së programit informativ nga 24.47% në 46.51% dhe një rritje e vogël e programit edukativ, përderisa kemi ulje të sasisë së

programit për fëmijë. Programi argëtues është ulur gjithashtu nga 39.6% të deklaruar në 30.24%. Lidhur me komunikimet komerciale audiovizuale, është vërejtur se sasia e tyre e transmetuar gjatë periudhës së monitoruar është dukshëm më e vogël se ajo e deklaruar në licencë, nga 12.74% në 2.11%.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm dedikuar komunitetit serb.

Ndërsa, lidhur me burimin e programit, nga monitorimi vërehet rritjes e sasisë së kategorisë së programit vetanak, atij të bashkëprodhuar dhe të blerë, përderisa kemi një zvogëlim të konsiderueshëm të programit të ritransmetuar.

Burimi i programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program origjinal	74.35	92.14
	a) Program origjinal vetanak	35.44	41.28
	b) Program origjinal i bashkëprodhuar	1.02	2.71
	c) Program origjinal i blerë	37.89	48.15
2	Program i ritransmetuar	25.65	7.86
3	Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	0	0
Gjithsej		100	100

KLAN KOSOVA - Kjo OSHMA është licencuar me datë 18 shkurt 2009. Më datë 29 qershor 2017, Komisioni i KPM-së ka marrë vendim për miratimin e kërkesës së Klan Kosova, për ndërrim të skemës programore të pasuruar me program në interes të publikut. Monitorimi është bërë nga data 18 janar 2018 deri me datë 24 janar 2018, më qëllim të vlerësimit të pajtueshmërisë së Klan Kosova me Pjesën 3 të Licencës së KPM-së.


Lidhur me llojin e programit, në bazë të monitorimit është gjetur se skema javore përbëhet:

38.88% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 2.08% programe për fëmijë, 11.33% programe edukative, 23.45% programe argëtuese, 4.04% programe sportive, 13.32% KKAV dhe paralajmërim programesh 6.9%. Në kuadër të programit informativ, lajmet përbëjnë 8.27% të saj.

Në përgjithësi, ky subjekt gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 59.19% program të shërbimit publik, 27.49% program argëtues dhe rreth 13.22% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu reklamimin televiziv dhe teleshopping.

Sipas Tabelës për Llojin e Programit në Pjesën 3 të Licencës, KLAN KOSOVA ka deklaruar se skema javore përbëhet prej: 27% program informativ, përfshirë lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 4% program për fëmijë, 21% programe edukative, 36% program argëtues, 4% program sportiv dhe 8% KKAV.

Nga krahasimi vërehet rritje e konsiderueshme e sasisë së programit informativ, ndërsa kemi përqindje më të vogël të sasisë së programeve të fëmijëve dhe programit edukativ në krahasim me të dhënat e deklaruara në Licencë. Programi argëtues po ashtu është zvogëluar nga 36% të deklaruar në 23.45% në bazë të monitorimit. Sa i përket komunikimeve komerciale audiovizuale, nga krahasimi mund të shihet se ka rritje të sasisë së tyre, në raport me ato të deklaruara.



Lidhur me gjuhën transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Sa i përket Burimit të Programit, KLAN KOSOVA ka deklaruar se përqindja e programit javor do të përbëhet prej: Program origjinal 64.00% (duke përfshirë nënkategoritë: Program origjinal vetanak 54.00%, Program origjinal i bashkëprodhuar 5.00%, Program origjinal i blerë 5.00%), Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij 10.00%. si dhe repriza të emisioneve 26.00%.

Nga të gjeturat e monitorimit, është gjetur se KLAN KOSOVA transmeton 68.24% program origjinal vetanak duke përfshirë këtu nënkategoritë: Program origjinal vetanak 50.55%, Program origjinal i bashkëprodhuar 1.92%, Program origjinal i blerë 15.77%. Program i shkëmbyer me subjektet tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij 6.32%. si dhe repriza të emisioneve 25.43%.

Nga krahasimi shihet se nuk ka ndryshim prej një të katërtës sa i përket kategorive të burimit të programit. Por, nga monitorimi është vërejtur ndryshim te nënkategoria program origjinal i blerë, ku KLAN KOSOVA ka deklaruar se do të transmetojë program të blerë 5.00%, ndërsa gjatë periudhës monitoruese ka transmetuar rreth 15.77% program origjinal të blerë, përfshirë këtu dokumentar, filma të huaj dhe seriale. Ndryshime tjera në kategoritë tjera janë të vogla.

Burimi i Programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program Origjinal	64	68.24
	a. Program origjinal vetanak	54	50.55
	b. Program origjinal i bashkëprodhuar	5	1.92
	c. Program origjinal i blerë	5	15.77
2	Program i ritransmetuar		
3	Program i shkëmbyer me subjekte tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	10	6.32
4	Repriza të emisioneve në Klan Kosova	26	25.43
Gjithsej		100	100

RROKUM TV - Kjo OSHMA është një nga televizionet e para i cili është licencuar nga KPM për ofrim të shërbimeve programore përmes operatorëve të shpërndarjes. Është licencuar me datë 28 gusht 2008 dhe ka deklaruar dhe se ky medium do të transmetoj program gjeneralistik në gjuhën shqipe në dialektin gegërisht. Monitorimi i këtij subjekti është bërë për periudhën 3 deri më 9 mars 2018.


Sa i përket llojit të programit, nga monitorimi është gjetur se kjo OSHMA transmeton: 33.5% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, 21.97% programe edukative, 30.68% programe argëtuese, 3.37% programe sportive, 2.26% KKA V dhe paralajmërim programesh 3.92%. Në kuadër të programit informativ, lajmet përbëjnë 20.4% të saj. Gjatë

periudhës transmetuese (më 4 mars 2018), për shkaqe teknike nuk ka pasur sinjal në sistemin e monitorimit në sasi prej 4.31%.

Në përgjithësi, gjatë kësaj periudhe, ky subjekt ka transmetuar rreth 59.39% program të shërbimit publik, 34.05% program argëtues dhe rreth 2.26% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu reklamimin televiziv. Ndësa, siç është theksuar më lartë sasia prej 4.31% është koha që nuk ka pasur sinjal.

Me rastin e licencimit, RROKUM TV ka deklaruar se do të transmetoj 80% program të shërbimit publik, përkatësisht program kulturor, dhe 20% program argëtues.

Sipas të gjetura të monitorimit është gjetur se ka ndryshim të theksuar në kategorinë e programit kulturor, ku nga 80% të sasisë së deklaruar në licencë në periudhën monitoruese nuk ka pasur ndonjë program kulturor. Ndërsa, sasia e programit argëtues është rritur nga 20% të deklaruar në licencë në 30.68%. Nga monitorimi shihet se për dallim nga të dhënat e deklaruara në licencë, ky subjekt transmeton edhe kategori tjera programore, përfshirë këtu programin informativ, përfshirë lajmet dhe debatet/intervistat, program edukativ, program sportiv dhe reklamim televiziv.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Kurse në kategorinë Burimi i Programit, RROKUM TV ka deklaruar se do të transmetoj 80% program vetanak, 15% program komercial nga jashtë dhe 5% program i ritransmetuar.

Bazuar në gjetjet e monitorimit dhe krahasimin e të dhënave del që ky medium ka ulur përqindjen e transmetimit të programeve vetanake nga 80% të deklaruar në 40.84% sipas

gjetjeve të monitorimit. Kurse, ka rritur përqindjen e transmetimit të programeve komerciale apo të blerë nga jashtë nga 15% të deklaruar në 46.98%.

Diferencë më e vogël e sasisë është vërejtur në kategorinë e programit të ritransmetuar nga 5% të deklaruar në 7.87% në periudhën monitoruese.

Burimi i Programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program Origjinal	100	100
	a. Prodhim i veti	80	40.84
	b. Komercial nga jashtë	15	46.98
	c. Program i ritransmetuar	5	7.87
2	S`ka sinjal		4.31
Gjithsej		100	100

TRIBUNA CHANNEL - Kjo OSHMA, me datë 26 shkurt 2015, ka nënshkruar Vendimin për ndërrim të pronësisë nga ish “Top Kosova Info” në “TRIBUNA CHANNEL”, njëkohësisht edhe ndërrimin e skemës programore të këtij televizioni. Pas disa ndryshimeve tjera në skemën programore, TRIBUNA CHANNEL ka kërkuar ndërrim të skemës programore dhe më datë 30 nëntor 2016 ka nënshkruar Pjesën 3 të Licencës së KPM-së me ndryshimet e deklaruara.


Monitorimi i këtij subjekti është bërë për periudhën nga data 10 shkurt deri më 15 shkurt 2018.

Sipas të gjeturave nga monitorimi, TRIBUNA CHANNEL ofron për publikun rreth: 41.62% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 6.99% programe për fëmijë, 2.37% programe edukative, 23.96% programe argëtuese, përfshirë filmat dhe serialet, 7.2% programe sportive, 11.74% KKAV dhe paralajmërim programesh 6.12%. Në kuadër të programit informativ, lajmet përbëjnë 2.31% të programit informativ.

Në përgjithësi, ky subjekt gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 57.1% program të shërbimit publik, 31.16% program argëtues dhe rreth 11.74% komunikime komerciale audiovizuele, përfshirë këtu reklamimin televiziv dhe teleshoping.

Në Pjesën 3 të Licencës ky televizion ka deklaruar se do të ofrojë: 38.33% program informativ, përkatësisht lajme dhe programe politike, aktualitete, 2.33% program për fëmijë, 26.2% program argëtues, 7.92% program sportiv, 18.67% KKAV dhe promo 6.55%.

Nga krahasimi i të dhënave mund të shihet rritje e sasisë së programit informativ, programit për fëmijë dhe atij edukativ, përderisa vërehet zvogëlim i programit argëtues dhe komunikimeve komerciale audiovizuele.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Lidhur me burimin e programit, nga krahasimi shihet se nuk ka ndryshim të madh të sasisë së përqindjeve të programit të deklaruar dhe të dhënave nga monitorimi.

Burimi i Programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program Original		
	a. Program original vetanak	77.34	76.88
	b. program original i bashkë prodhuar		
	c. Program original i blerë	22.66	23.12
2	I shkëmbyer me subjekte tjera transmetuese		
Gjithsej		100	100


1ST CHANNEL - është pajisur me licencë në janar të vitit 2013. Monitorimi i këtij subjekti është bërë nga data 27 janar deri me 2 shkurt 2018.

Sa i përket llojit të programit, nga monitorimi është gjetur se kjo OSHMA transmeton: 6.59% program informativ, përfshirë këtu programe për ngjarje aktuale, 0.8% programe për fëmijë, 88.74% programe argëtuese, ku programi muzikor përbënë 63.23% të kësaj kategorie, 3.77% KKAV dhe paralajmërim programesh 0.1%. Ky subjekt nuk ka transmetuar edicione të lajmeve gjatë periudhës monitoruese, ndërsa programi për fëmijë ka përfshirë vetëm muzikë për fëmijë.

Në përgjithësi, kjo OSHMA gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 7.49% program të shërbimit publik, 88.74% program argëtues dhe rreth 3.77% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu reklamimin televiziv.

Ndërsa, sipas Licencës, skema javore e kësaj OSHMA-ja përbëhet prej: 15% program informativ, përfshirë lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 6% program për fëmijë, 15% programe edukative, 50% program argëtues, përfshirë programet muzikore, 5% program sportiv dhe 9% KKAV.

Nga krahasimi mund të shihet se zvogëlim të theksuar të sasisë së përqindjes në kategoritë e programit informativ dhe programit për fëmijë si dhe eliminim të kategorive të programit edukativ dhe sportiv. Ndërsa, nga monitorimi vërehet rritje e dukshme e programit argëtues, kryesisht program muzikor. Sa i përket KKAV-ve, vërehet se sasia e transmetimit të tyre është dukshme më e vogël prej 3.77% se ajo e deklaruar në licencë 9%.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm në gjuhën shqipe.

Ndërsa, lidhur me burimin e programit, nga monitorimi vërehet zvogëlim i theksuar i nënkategorisë së programit vetanak dhe rritje e programit të blerë nga 0% të deklaruar në 48.23% të transmetuar në periudhën monitoruese. Po ashtu, nga krahasimi mund të shihet se ky subjekt ka eliminuar kategoritë e programeve të ritransmetuar dhe ato të shkëmbyer.

Burimi i Programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program Origjinal	80	100
	a. Program origjinal vetanak	70	36.77
	b. program origjinal i bashkë prodhuar	10	15
	c. Program origjinal i blerë		48.23
2	Program i ritransmetuar	10	
3	Program i shkëmbyer me subjekte tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	10	
Gjithsej		100	100

RTK2 - Kjo OSHMA është licencuar me datë 31 nëntor 2012 si ofrues i shërbimeve programore në kuadër të transmetuesit publik, me transmetim të programeve në gjuhën serbe.

Monitorimi i kësaj OSHMA-je është bërë nga data 29 janar deri me datë 4 shkurt 2018.


Sa i përket llojit të programit, nga monitorimi është gjetur se kjo OSHMA transmeton: 48.29% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 0.3% programe për fëmijë, 28.61% programe edukative, 12.62% programe kulturore, 8.62% programe argëtuese, 0.26% programe sportive, 0.63% KKAV dhe paralajmërim programesh 0.67%. Në kuadër të programit informativ, lajmet përbëjnë 15.39% të saj, ndërsa i tërë programi për fëmijë është i tipit edukativ.

Në përgjithësi, ky subjekt gjatë kësaj periudhe, ka transmetuar rreth 90.49% program të shërbimit publik, 8.88% program argëtues dhe rreth 0.63% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu reklamimin televiziv.

Sipas tabelës për Llojin e Programit në Pjesën 3 të Licencës, RTK2 ka deklaruar se programi javor do të përbëhet nga: 32% program informativ, përfshirë këtu lajmet, program politik dhe aktualitete, 5% program për fëmijë, 15% program edukativ, 36% program argëtues, 7% program sportiv dhe 5% KKAV.

Nga krahasimi mund të shihet se ky subjekt ka rritur në sasi të konsiderueshme programin informativ dhe atë edukativ/kulturor, ndërsa është vërejtur se është zvogëluar sasia e programit për fëmijë, programit argëtues, kryesisht filmave dhe programit muzikor, dhe programit sportiv.

Po ashtu, vërehet zvogëlim i dukshëm prej 0.63% më sasinë e KKAV-ve në krahasim me ato të deklaruar prej 5%.



Përveç programit në gjuhën serbe, me rreth 98.23%, gjatë javës së monitoruar është gjetur se RTK 2 ka transmetuar edhe 1.77% program në gjuhë të minoriteteve tjera, prej tyre: 0.33% në gjuhën boshnjake, 0.45% në gjuhën rome, 0.57% në gjuhën turke dhe 0.41% në gjuhën malazeze.

Tabelat lidhur me gjuhët transmetuese

Programet në gjuhët e komuniteteve	(s) /javë	(%) / javë
Serb	594110	98.23
Boshnjak	2011	0.33
Romë	2713	0.45
Turk	3473	0.57
Malazeze	2493	0.41
Gjithsej	604800	100

Ndërsa, lidhur me burimin e programit, përkatësisht te kategoria program original, nga monitorimi shihet se kemi rritje të konsiderueshme të sasisë së programit vetanak 71.40% nga 40% te deklaruar dhe zvogëlim të dukshëm të programit të bashkëprodhuar në 1.19% nga 30% te deklaruar. Ndërsa te kategoria program i ritransmetuar është vërejtur një rritje prej 10% në 14.22%, ndërsa është vërejtur se gjatë periudhës së monitoruar nuk është transmetuar ndonjë

program i shkëmbyer me subjekte tjera transmetuese, përderisa në licencë RTK2 ka deklaruar se do të ketë rreth 5% të kësaj kategorie.

Burimi i Programit		% e deklaruar	% sipas monitorimit
1	Program Origjinal	85	85.75
	a. Program origjinal vetanak	40	71.40
	b. program origjinal i bashkë prodhuar	30	1.19
	c. Program origjinal i blerë	15	13.19
2	Program i ritransmetuar	10	14.22
	Program i shkëmbyer me subjekte tjera transmetuese të vendit apo jashtë tij	5	0
Gjithsej		100	100

TV KIM - Kjo OSHMA është licencuar me datë 15 nëntor 2012 si ofrues i shërbimeve programore përmes operatorëve të shpërndarjes me transmetim të programeve në gjuhën serbe.

Monitorimi i këtij subjekti është bërë nga data 04 shkurt deri me datë 10 shkurt 2018.


Në lidhje me Llojin e Programit, nga monitorimi është gjetur se ky subjekt ka transmetuar: 14% program informativ, përfshirë këtu lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale, 2.4% programe për fëmijë, 13.67% programe edukative, 1.65% programe kulturore, 65.58% programe argëtuese, prej tyre filmat përbëjnë 51.1%, 1.98% KKAV dhe paralajmërim programesh 0.72%. Në kuadër të programit informativ, lajmet përbëjnë 4.3% të saj.

Në përgjithësi, TV KIM ka transmetuar rreth 32.44% program të shërbimit publik, 65.58% program argëtues dhe rreth 1.98% komunikime komerciale audiovizuale, përfshirë këtu vetëm reklamimin televiziv.

Ndërsa, në Pjesën 3 të Licencës TV KIM ka deklaruar se do të transmetojë: 25% program informativ, përfshirë lajme, debate, intervista, ngjarje aktuale dhe programe tjera, 5% program për fëmijë, 10% programe edukative, 40% program argëtues, përfshirë këtu programin muzikor, 10% program sportiv, 5% KKAV dhe 5% paralajmërim programesh.

Nga krahasimi i të dhënave të deklaruara me ato të gjetura nga monitorimi del se TV KIM ka rritur përqindjen e transmetimit të programeve argëtuese dhe programit edukativ, ndërsa ka zvogëluar dukshëm kategoritë tjera programore. Kurse, në periudhën monitoruese nuk ka transmetuar ndonjë program sportiv, përderisa në licencë ka deklaruar se në skemën programore

do të ketë rreth 5% program sportiv. Po ashtu, sasia e KKAV-ve të transmetuar është dukshëm më e vogël nga ajo e deklaruar në licencë.



Sa i përket gjuhëve transmetuese, kjo OSHMA transmeton program vetëm në gjuhë serbe.

